



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2020:128349
Datë: 30.04.2024
Numri i dokumentit: 05639448
C.nr. 387/20

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ- Dega në Kaçanik, si gjykatë civile e shkallës së parë, gjyqtari Riza Livoreka, si gjyqtar individual, me sekretarën juridike Azemine Berisha, në lëndën kontestimore të paditësit S. M.nga Kaçaniku, të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat F. G. nga Prishtina, kundër të paditurës K. K.-D. K. A, për çështjen kontestuese pagesa e shujtës dhe pagave jubilarë, jashtë seancës gjyqësore me datën 30.04.2024 dhe në të njëjtën ditë bëri përpilimin me shkrim të këtij:

A K T V E N D I M

I. Padia e paditësit S. M.nga Kaçaniku, e ushtruar më datën 06.10.2020, kundër të paditurës K. K.-D. K. A, për çështjen kontestuese pagesa e shujtës dhe pagave jubilarë, pranohet e TËRHEQUR.

II. Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë.

III. Gjykata konstaton se pala paditëse e ka paguar taksën në shumë prej 20.00€, ndërsa sa i perkat shpenzimeve tjera secila palë i përballon shpenzimet e krijuara.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit më datën 06.10.2020, në Gjykatën Themelore në Ferizaj Dega në Kaçanik, ka ushtruar padi kundër të paditurës K. K.-D. K. A, për çështjen kontestuese pagesa e shujtës dhe pagave jubilarë. Po ashtu me këtë padi e ka kërkuar që shumat e pranuar nga gjykata të paguhen me kamatë prej 8%, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, po ashtu i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

I autorizuari i paditësit , në Gjykatë e ka dorëzuar parashtresën me të cilën e ka njoftuar gjykatën se e bënë tërheqjen e padisë, sepse me të paditurën e kanë zgjidhur qeshjen me marrëveshje në procedurë jashtë gjyqësorë.

Gjykata padinë e paditësit e konsideroj të tërhequr, sepse paditësit përmes të autorizuarit me parashtresën, e ka njoftuar gjykatën se e kanë tërheqjen e padisë, sepse me të paditurën e kanë zgjidhur në procedurë jashtë gjyqësore.

Me dispozitën e nenit 261. 2 të LPK-së, është e paraparë se pala paditëse mund ta tërheq padinë edhe ma vonë deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor , në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë, e në rastin konkret e paditura e ka dhen pëlqimin me rastin e bërje së pagesës.

Gjykata aktvendimin e ka nxjerr duke u bazuar në nenit 261 par.3 të LPK-së, dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa sepse me dispozitën e nenit 261.4 të LPK-së është paraparë se kundër aktvendimit me të cilin konstatohet se është tërhequr padia nuk lejohet ankimi.

Gjykata sa i përket shpenzimeve të procedurës vendosi qe secila palë ti përballon shpenzimet e krijuar dukë e pasur për bazë rezultatin e procedurë.

Nga se u theksua më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Dega në Kaçanik

C.nr.387/20 prej datës 30.04.2024

Gjyqtari
Riza LIVOREKA

Dërguar me datën 30.04.2024